

Si janë përkthyer zotimet e platformës zgjedhore të LDK-së në programin qeverisës dhe atë legjislativ të Qeverisë Hoti

Analizë e shkurtër

COPYRIGHT © 2020. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jo komerciale. Kurdo dhe kushdo që përdorë citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,
10 000, Prishtinë, Kosovë.

Tel.: +383 (0) 38 248 038

E-mail: info@kdi-kosova.org

Ueb: www.kdi-kosova.org

Autorë: Mehdi Sejdiu
Agnesa Haxhiu

PËRMBAJTJA:

1.	Përmbledhje e gjetjeve kryesore	4
2.	Hyrje	5
3.	Kabineti qeveritar	5
4.	Analiza e programit zgjedhor dhe programit qeverisës	7
a)	Menaxhimi i pandemisë	9
b)	Marrëdhëniet me jashtë	9
c)	Sundimi i ligjit dhe administrata	10
d)	Ekonomia dhe infrastruktura	11
e)	Shteti social, mjedisi dhe kultura	12
5.	Programi legjislativ i qeverisë	13

1. Përmbledhje e gjetjeve kryesore

- Dy objektivat kryesore të programit qeverisës të qeverisë Hoti janë menaxhimi i pandemisë Covid – 19 dhe rimëkëmbja ekonomike. Në menaxhimin e pandemisë, programi ndjek rekomandimet e instituteve shëndetësore ndërkombëtare, por për shkak të hapjes së menjëhershme, strategjia afatgjatë e menaxhimit të pandemisë nuk ka dhënë efekt deri tani. Kosova gjatë muajve korrik - gusht ka qenë një prej vendeve më të prekura me Covid -19 në Evropë, qytetarët me simptoma nuk kanë pasur mundësi të testohen, ndërsa numri i vdekjeve është rritur ndjeshëm.
- Për rimëkëmbjen ekonomike, Qeveria planifikon një sërë masash që përfshijnë: lehtësimin e qasjes në kredi për ndërmarrje, zvogëlimi masat për mbështetje në punësim, bujqësi, stimulim të kërkesës agregate, rishikimi i buxhetit, kredi financiare nga institucione ndërkombëtare etj. Për marrjen e kredive financiare, Qeverisë i duhet të krijojë konsensus të gjerë politik ngaqë ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare kërkon 2/3 e deputetëve në Kuvend.
- Programi Qeverisës në aspekt ideologjik ka një qëndrim të qendrës së djathtë. Në fushën e ekonomisë, fokusi është në sektorin privat, ndërsa në politikat sociale fokusi është tek rimodelimi i sistemit pensional. Ai përmban politika ekonomike liberale si mbështetja për tregun e lirë, buxhet të balancuar, heqjen e barrierave ekonomike, krijimin e ushtrisë, anëtarësimin në organizata ndërkombëtare, etj.
- Nga gjithsej 52 premtime zgjedhore të artikuluar në kuadër të platformës zgjedhore të LDK-së, 38 prej tyre janë inkorporuar në programin qeverisës, 5 tjera janë përmendur vetëm pjesërisht ndërsa 9 të tjera nuk janë fare të inkorporuara.
- Në platformën zgjedhore, LDK kishte planifikuar 12 ministri dhe 24 zëvendësministra. Numri i ministrave u rrit në 16, të zëvendësministrave në 46 (deri tani), por gjithashtu vetëm 3 nga 16 ministra janë gra. Disa ministri si ajo e Ekonomisë, Bujqësisë dhe të Kulturës kanë nga 5 zv. ministra.
- Programi legjislativ i Qeverisë së Kosovës për këtë vit përmban gjithsej 129 projektligje. Nga këto 129 projektligje, 90 janë të reja dhe 39 të tjera janë plotësim- ndryshim i ligjeve ekzistuese. Nga tërësia e këtyre projektligjeve, 16 prej tyre janë projektligje për ratifikim të marrëveshjeve ndërkombëtare.
- 63 projektligje apo shprehur në përqindje 49% e programit legjislativ të këtij viti është i bartur nga programi legjislativ i vitit të kaluar. Sa i përket fokusit në ligje, Qeveria ka paraparë më së shumti ligje në fushën e politikave ekonomike, gjithsej 45 projektligje, 12 prej të cilave rrjedhin nga plani për rimëkëmbjen ekonomike. Ndërkaq, në program legjislativ nuk është paraparë hartimi i kuadrit ligjor për parandalimin dhe menaxhimin e pandemisë.

2. Hyrje

Qeveria Hoti u formua më 3 qershor 2020, pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit ndaj Qeverisë Kurti, të iniciuar nga subjekti politik LDK, që ishte edhe partner i koalicionit. Pas rrëzimit të Qeverisë Kurti, vendimi i Gjykatës Kushtetuese i dha të drejtë Presidentit që të kalojë mandatin tek partia e dytë më e madhe për të formuar qeverinë pa shkuar në zgjedhje.¹ Qeveria Hoti e përbërë nga koalicioni LDK, AAK, NISMA, LS dhe minoritetet tjera, me të marrë mandatin, prezantoi programin e saj qeverisës i cili kishte dy objektiva kryesore: menaxhimin e pandemisë dhe rimëkëmbjen ekonomike. Ndërkohë që Qeveria për t'u përballur me këto çështje ka një shumicë minimale në kuvend, gjegjësisht 61 vota.

Kjo analizë tenton të trajtojë rrugëtimin e procesit, nga platforma zgjedhore e propozuar nga LDK deri tek përkthimi i saj në program qeverisës e në plan legjislativ, duke mos anashkaluar edhe konfigurimin e kabinetit ministror. Në pjesën e kabinetit qeveritar do të analizohet struktura dhe përbërja e kabinetit të Qeverisë Hoti, edhe në raport me qeveritë e kaluara në Kosovë si dhe qeveritë e rajonit. Në pjesën e programit qeverisës do të analizohet nëse komponentet e programit qeverisës janë në harmoni me programin zgjedhor të LDK-së. Ndërsa në pjesën e tretë, analiza do të fokusohet në atë se sa është përkthyer programi qeverisës në programin legjislativ.

3. Kabineti qeveritar

Qeveria Hoti përbëhet nga 16 ministri, katër më shumë se që kishte premtuar në programin e saj zgjedhor. Ndërkaq, sa i përket numrit të zëvendësministrave, LDK në programin zgjedhor kishte premtuar jo më shumë se 24 zv. Ministra, por deri tani nga informata publike ka emëruar 46, pra thuhet dyfishoi numrin e zv. ministrave.² Në aspektin e përfaqësimit gjinor, Qeveria Hoti emëroi vetëm tri gra ministre dhe një grua zëvendës kryeministre.

LDK në këtë qeveri përfshiu të gjithë ministrat që kishte në Qeverinë Kurti, përveç Lumir Abdixhikut që refuzoi të jetë pjesë e këtij kabineti, edhe pse një gjë e tillë i është kërkuar nga partia.

Ministrat që vijnë nga subjekti politik AAK konsiderohen të rinj në poste ministrare, pasi asnjë nga ta nuk ka mbajtur më herët ndonjë post ministror, shtu këtu Ministrin e Arsimit, Ramë Lika i cili është edhe jashtë partiak. Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi dhe Ministrja e Punëve të Jashtme, Meliza Haradinaj paraprakisht ishin këshilltarë në Qeverinë Haradinaj. Ndërsa Ministri për Ekonomi dhe Ambient, Blerim Kuçi vazhdon të jetë edhe sekretar i përgjithshëm i AAK-së. Në anën tjetër, subjekti politik NISMA ka dy ministri dhe një post të zëvendës kryeministrit. Zv. Kryeministrja Albulena Balaj ishte deputete e NISMA-s në dy legjislaturat e fundit. Një ndryshim që vihet re tek emërimet e këtyre dy partive (AAK dhe Nisma)

¹Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, KO 72/20, 30.04.2020 shih: "AKTGJYKIM në rastin nr. KO72/20" 1 qershor 2020, e qasshme në <https://bit.ly/2AaW1gk>

²Në programin zgjedhor të LDK-së u premtuan 12 ministri.

është tërheqja e Fatmir Limajt dhe Ramush Haradinajt nga ky kabinet, si dhe emërimi i figurave jo shumë të njohura në poste ministrore.

Nga këto emëtime, vëmendje mediale kanë marrë më shumë emërimi i Melizaj Haradinajt dhe Ramë Lika. Për këtë të fundit organizata për rritjen e cilësisë në arsim ORCA ka reaguar se emërimi i tij është i dëmshëm sepse ai ishte avancuar në Universitetin e Prishtinës përmes plagjiaturës dhe mashtrimit akademik i njohur si rasti i Supermenëve të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike.³ Ndërkohë Kallxo.com kishte raportuar që e emëruara Meliza Haradinaj - Stublla për politikë të jashtme ishte dënuar për deklaram të rrejshëm të pasurisë.

Qeveria Hoti ka numër më të vogël të ministrive në krahasim me qeveritë e kaluara, përveç Qeverisë Kurti që kishte 15 ministri. Sa i përket zv. ministrave, më shumë ka pasur vetëm Qeveria Haradinaj që ishte edhe qeveria me kabinetin më të madh të pasluftës. Numri i madh i zëvendësministrave në Qeverinë Hoti nuk ndjek ndonjë logjikë të caktuar të qeverisjes apo ndarjeve të portofoliove. Kështu, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit e drejtuar nga Blerim Kuqi ka pesë zëvendësministra, tre prej tyre nga AAK-ja. Ngjashëm edhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit drejtuar nga Vlora Dumoshi ka pesë zëvendësministra.

Tabela 1 Madhësia e qeverive të Kosovës⁴

Qeveria	Viti	Nr. i Ministrave	Nr. i grave Ministre	Nr. i zv. ministrave
Hoti	2020	16	3	46
Kurti	2020	15	5	35
Haradinaj II	2017-2019	21	2	80+
Mustafa	2014-2017	21	2	45
Thaçi II	2011-2014	20 ⁵	2	45
Thaçi I	2007-2011	19	2	38

Shikuar nga numri i ministrive në nivel të rajonit, Qeveria e Kosovës është e njëjtë me Qeverinë e Shqipërisë dhe Bosnjë e Hercegovinës, ndërsa më e madhe krahasuar me Qeverinë e Serbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut. Në aspektin gjinor, pjesëmarrja e grave në poste ministrore në Qeverinë e Kosovës është e parafundit në rajon (me vetëm 18.75%).

Tabela 2 Madhësia e qeverive të ndryshme të Ballkanit

Vendi	Nr. i Ministrive ⁶	Nr. i Grave Ministre	Në përqindje
Kosova	16	3	18.75

³ “Emërimi i mashtruesit si Ministër i Arsimit – Sulm mbi cilësinë”, komunikatë për shtyp, ORCA

⁴ Deri në vitin 2014 të dhënat janë nga Instituti GAP ndërsa aspekti gjinor nga D4D.

⁵ 19 Ministri dhe 20 ministra, meqë njëri ishte pa portofol.

⁶ Vetëm numri i ministrive është llogaritur dhe nuk janë përfshirë ministrat pa portofol.

5. Vetingu	✓	32. Fuqizimi i shkollave profesionale	✓
6. Rritja e buxhetit për policinë	✓	33. Koordinimi i donatorëve për fushën e arsimit dhe të shkencës	✓
7. Sigurimi i jetës së policëve	✓	34. Organizimi i kampuseve mësimore	✗
8. Shërbimi ushtarak i obligueshëm	Pjesërisht	35. Profilizimi i universiteteve	✓
9. Programi familjar për nënat dhe foshnjat	✓	36. Avancimi i kapaciteteve për kërkim shkencor	✓
10. Pushim prindëror	✓	37. Reforma menaxheriale në sektorin e shëndetësisë	Pjesërisht
11. Subvencioni i banimit për qiftet e reja	✓	38. Rritja e pjesëmarrjes në edukimin parashkollor	Pjesërisht
12. Programi nacional i kujdesit parashkollor	✓	39. Gjithëpërfshirja në arsim	✓
13. Rimodelimi i sistemit pensional	✓	40. Themelimi dhe funksionalizimi i Fondit për sigurime shëndetësore	✓
14. Themelimi i fondit për investime	✓	41. Rritje e buxhetit për shëndetësi	✓
15. Tregu dhe konkurrueshmëria	✓	42. Themelimi i spitalit të Prishtinës	✓
16. Zhbërja e monopoleve në ekonominë e tregut	✓	43. Krijimi i Rrjetit të mjekëve në diasporë	✗
17. Programi gjithëpërfshirës i punësimit	Pjesërisht	44. Modernizimi i infrastrukturës shëndetësore	✓
18. Rritja e buxhetit të shtetit në 3 miliardë për 4 vite qeverisje	✗	45. Riorganizimi i SHSKUK-së	✓
19. Programi '8 orë punë' në sektorin privat	✗	46. Themelimi i Universitetit të Shkencave Mjekësore	✗
20. Mbledhja e TVSH-së përmes bashkimit të ATK-së dhe Doganave në një agjenci të vetme	✓	47. Liberalizimi i vizave	✓
21. 18. Fuqizimi i Fondit të Kosovës për Garanci Kreditore	✓	48. Reciprociteti me Serbinë	✗
22. Avancimin e sektorit të teknologjisë informative	✓	49. Zhvillimi i marrëdhënieve shumëpalëshe	✓
23. Zhvillimi i sektorit të bujqësisë	✓	50. Riorganizimi diplomatik	✓
24. Zhvillimi i politikave për mbrojtje të ambientit	✓	51. Zhvillimi i marrëdhënieve dypalëshe	✓
25. Pavarësia energjetike	✓	52. Dialogu me Serbinë	✓
26. Ndërtimi i shtatë stadioneve regionale	✗		
27. Ngrohja qendrore në kryeqendrat e Kosovës	✓		

Programi Qeverisës 2020-2023 ka 15 pika në të cilat janë të paraqitura objektivat dhe prioritetet e qeverisë për katër vitet e ardhshme.⁷ Për të analizuar këtë program ne jemi fokusuar në 5 sfera të ndryshme: 1. Menaxhimi i pandemisë 2. Marrëdhëniet me Jashtë, 3. Sundimi i ligjit dhe administrata, 4. Ekonomia dhe infrastruktura, 5. Shteti social, mjedisi dhe kultura.

a) Menaxhimi i pandemisë

Bazuar në programin qeverisës, plani i Qeverisë për menaxhimin e pandemisë është i ndarë në dy faza: në menaxhimin e fazës emergjente dhe asaj afatgjate. Faza emergjente është e planifikuar të jetë disa javë dhe të përfshijë masa izolimi dhe distancim shoqëror të popullatës, që vazhdon me marrjen e mostrave testuese në popullatë për të vlerësuar gjendjen e infeksionit aktiv, duke vazhduar me rihapje eventuale. Ndërsa plani afatgjatë është gjashtë pikësh: 1. Të ketë kapacitete për numër të madh testesh në popullatën e përgjithshme dhe decentralizimin e testeve, 2. Strukturë qendrore të mbikëqyrjes, 3. Forcimi i kapaciteteve rajonale të mbikëqyrjes, 4. Rrjetëzim midis strukturave operative, 5. Mandati ligjor, dhe 6. Një strategji komunikimi.

Plani për menaxhimin e pandemisë është i bazuar në rekomandime të Qendrës Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollimin e Sëmundjeve (ECDC), të Organizatës Botërore të Shëndetësisë si dhe Komisionit Evropian. Në programin qeverisës (f.5) parashihej vlerësimi i infeksionit aktiv në popullsinë e përgjithshme “mostra testuese në masë të madhe” për të konstatuar gjendjen e imunitetit të popullatës dhe përkritazi të rregullohet hapja.

Ndërkohë edhe mandati ligjor për ndërmarrjen e masave fleksibile në përgjigje të kthimit të virusit është premtuar në program qeverisës. Mirëpo në programin legjislativ nuk reflektohet diçka e tillë edhe pse Gjykata Kushtetuese kishte rekomanduar që të krijohet baza ligjore për këtë çështje. Kurse nisma ligjore e Kuvendit për menaxhimin e pandemisë nuk ka marr mbështetje nga ana e Qeverisë.

b) Marrëdhëniet me jashtë

Në marrëdhëniet ndërkombëtare, prioritetet i kësaj qeverie sipas programit qeverisës janë: mbrojtja dhe forcimi i sovranitetit shtetëror, partneriteti strategjik me SHBA-në dhe aleatë të tjerë, konsolidimi i subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës, marrëdhëniet dypalëshe me SHBA dhe vendet kryesore të BE-së, diplomacia ekonomike, anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare, bashkëpunim me rajonin dhe regjistrimi i diasporës.

Krahasuar me platformën zgjedhore të LDK-së, programi qeverisës ka pësuar disa ndryshime. LDK kishte premtuar reciprocitet ekonomik me Serbinë në programin zgjedhor, por pikërisht për këtë pikë pati mospajtime me Lëvizjen Vetëvendosje që çuan deri në rrëzimin e qeverisë Kurti. Me arsyetimin e

⁷“Programi Qeverisës 2020-2023”, Qeveria e Republikës së Kosovës, e qasur më 20 qershor 2020, e qasshme në: <https://bit.ly/3dP46F5>

rrezikimit të marrëdhënieve me SHBA-në dhe nevojës së vazhimit të dialogut, Kryeministri Hoti mori vendim për heqjen e reciprocitetit me Serbinë.

Sipas programit, **Dialogu me Serbinë** është forma e vetme për zgjidhje të çështjeve mes Serbisë dhe Kosovës. Dialogu shihet si proces që do të shpie në marrëveshje përfundimtare me Serbinë dhe njohje të Kosovës në kufijtë ekzistues. Sa i përket përfaqësimit, qeveria është palë negociuese që i përgjigjet Kuvendit, ndërsa presidenti do ta përfaqësojë vendin në bazë të kompetencave të tij kushtetuese. Kjo në praktikë nënkupton që edhe presidenti edhe kryeministri do të jenë të përfshirë në Dialog. Gjithashtu, qeveria beson se dialogu mund të jetë i suksesshëm vetëm me “angazhimin e të gjitha forcave politike parlamentare, si dhe përfshirjen e institucioneve akademike”.

Në programin qeverisës, **SHBA** shihet si partner strategjik i Kosovës dhe programi synon thellimin e partneritetit në të gjitha nivelet. **BE** gjithashtu konsiderohen partnerë strategjik të Kosovës. Në pjesën e integriteteve evropiane, Qeveria parasheh liberalizimin e vizave gjatë presidencës së Gjermanisë në BE, që është ambicioze sepse me shumë gjasa gjatë kësaj periudhe 6 mujore të presidencës gjermane ende do të jemi në pandemi, prandaj edhe liberalizimi i vizave është tejet i vështirë për Kosovën në këtë kohë. Ndër të tjerash, plani përfshin edhe harmonizim të legjislacionit me BE-në, rritjen e pjesëmarrjes në forume rajonale e ndërkombëtare, mobilitet të rinjëve në arsim të lartë në BE, etj. Nëse një politikë ka standarde të larta atëherë programi i referohet “sipas standardeve të BE-së”. Për shembull thuhet se praktikën për të parandaluar rrezikun nga lajmet e rreme do të bëhen sipas standardeve të BE-së (f.16) apo mbrojtja e konsumatorit në përputhje me standardet e BE-së (f.45) pa treguar saktësisht se çka janë këto standarde dhe se çka përmbajnë këto politika.

Për **ushtrinë**, Qeveria planifikon rritje të buxhetit për transformim të FSK-së në ushtri, rritjen e shpenzimeve deri në 2% të BPV-së sikurse kushti i vendeve anëtare të NATO-s, si dhe analiza dhe vlerësime për shërbimin e detyrueshëm ushtarak. Në aspektin e shërbimit të obligueshëm ushtarak, qeveria Hoti premton vetëm vlerësimin dhe analiza për shërbimin ushtarak, përkundër programit zgjedhor ku premtohet shërbim i detyrueshëm 3 mujor e jo vetëm analiza dhe vlerësime.

Sa i përket **ndërkombëtarizimit**, programi mëton ta bëjë Kosovën pjesë të organizatave ndërkombëtare. Ndër organizatat ku synohet anëtarësimi janë: Këshilli i Evropës, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh), Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ILO), INTERPOL, Unionin Ndërkombëtar të Telekomunikimit (ITU) dhe Unionin Postar Universal (UPU).

c) Sundimi i ligjit dhe administrata

Sa i përket sundimit të ligjit, programi qeverisës fokusohet në synime të përgjithshme si forcim i institucioneve të drejtësisë, llogaridhënie dhe zbatueshmëri. Ndërsa premtohet reduktim i administratës publike, rishikim funksional i institucioneve, agjencive dhe organeve tjera të pavarura, bashkëpunim me pushtetin lokal, partneritet me shoqërinë civile, luftim të korrupsionit, etj. Programi Qeverisës edhe këtu

kryesisht i reflekton premtimet e prezantuara në platformën zgjedhore, përveç premtimit të 12 ministrive dhe nga dy zëvendësministrave për ministri, i cili nuk është aplikuar.

Sundimi i ligjit. Për drejtësinë është një kapitull i tërë me llogaridhënie, forcim të institucioneve të drejtësisë dhe luftimit të korrupsionit. Vetingu sipas programit do të zbatohet në bashkëpunim me SHBA-të dhe BE-në. Sundimi i ligjit përmbledhet me avancim të institucioneve, llogaridhënie dhe zbatueshmëri. Masat për përmirësimin e shtetit ligjor kufizohen në fjalë si “do të krijohen resurse të nevojshme” “do të krijohen baza ligjore” “do të krijohet mekanizmi për monitorimin e zbatimit të ligjeve” etj. Por ky seksion përmban pak politika konkrete për përmirësimin e shtetit ligjor në Kosovë. Programi qeverisës premtonte angazhim në **luftën kundër korrupsionit**, promovim të profesionalizmit me mbështetje më të mëdha buxhetore (f. 25) por masat për luftimin e korrupsionit nuk zënë vend të madh në programin qeverisës. Përkundër këtij fakti, në programin legjislativ është paraparë hartimi i disa ligjeve me këtë qëllim.

Qeverisja dhe efikasiteti i administratës. Orientimi i qeverisë është në eliminimin e strukturave të panevojshme burokratike dhe premtonte ligjin për qeverinë. Qeveria, sipas programit, premtonte reformë të administratës publike, funksionalizimin e e-qeverisjes, përfshirje të të gjitha bashkësive etnike në administratë. Qeveria gjithashtu planifikonte rishikim të kabinetit qeveritar dhe rishikim të agjencive për të reduktuar madhësinë e administratës publike.

d) Ekonomia dhe infrastruktura

Në rrafshin ekonomik programi ka dy seksione: rimëkëmbjen e ekonomisë dhe politikat e ekonomike. E para ka të bëjë vetëm me politikat ekonomike të qeverisë në luftimin e pasojave ekonomike të pandemisë covid-19, ndërsa e dyta ka të bëjë me politikat e përgjithshme ekonomike të qeverisë. Për shkak të ndryshimit të rrethanave, dhe shfaqjes së pandemisë gjashtë muaj pas zgjedhjeve në Kosovë, rimëkëmbja ekonomike nuk ka qenë pjesë e programit zgjedhor të LDK-së. Ndërsa në politikat ekonomike programi qeverisës merr nga programi zgjedhor pjesërisht programin e punësimit, zhbërjen e monopoleve, mbledhjen e TVSH-së, Fondin për Garanci Kreditore dhe Fondin për Investime. Sa i përket politikave ekonomike kryesore nga programi, “Programi 8 orë punë” nuk përmendet në program qeverisës. Në infrastrukturë rrugore, programi zgjedhor i LDK-së nuk ka pasur premtime të caktuara, prandaj nuk ka ndonjë lidhje mes programit zgjedhor dhe atij qeverisës në këtë drejtim.

Për **rimëkëmbjen ekonomike**, Qeveria Hoti ka planifikuar një buxhet prej 1.2 miliardë euro. Masat e rimëkëmbjes ekonomike përfshijnë: lehtësim i qasjes në kredi për ndërmarrje, zvogëlimi i barrës tatimore, masat për mbështetje në punësim, bujqësi, stimulim të kërkesës agregate, mbështetje për ndërmarrje publike, rishikimi i buxhetit për vitin 2020, mbështetje nga BQK, dhe mobilizim për financimin e masave. Të gjitha këto politika kanë për qëllim mbajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe minimizimit të dëmeve që ka shkaktuar recensionin dhe mos-aktiviteti ekonomik gjatë mbylljes dy mujore shkakut të pandemisë. Qeveria Hoti sikurse qeveritë e tjera në rajon, ka vendosur që të mbajë të hapur ekonominë gjatë pandemisë dhe të hap kufijtë tokësor dhe ajror. Sa i përket ndërhyrjes në ekonomi për rimëkëmbje ekonomike, LDK sikurse partitë e tjera të djathta nëpër gjithë botën kanë mbështetur pakot

emergjente dhe politikat ekonomike të marrjes së borxheve për të siguruar stabilitetin makroekonomik të vendit.⁸

Programi ekonomik i Qeverisë Hoti mund të konsiderohet i djathtë. Sektori privat, besimi në treg të lirë, borxhi publik i kufizuar dhe nën kontroll, lehtësime për kredi, lirime tatimore, etj., janë të gjitha karakteristika të ekonomisë së qendrës së djathtë. Si në platformën e partisë, e po ashtu edhe në programin qeverisës, programi ekonomik i LDK-së mbetet i pozicionuar në qendrën e djathtë.

Politika ekonomike e LDK-së është e fokusuar në sektorin privat, i cili shihet si bazë e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. LDK mbështet konkurrencën e lirë dhe parasheh rol të kufizuar të shtetit si rregullator i zhvillimit ekonomik (f.18). Lehtësimet që i përfshijnë janë rritja e kapaciteteve të inkubatorëve të biznesit, fondi zhvillimor dhe skema garantuese për kreditë, mbështetje e ndërmarrjeve të orientuara drejt eksportit, grante për investime për inovacione, zhvillimi i shërbimit këshillimor për biznese përmes Agjencive të Zhvillimit Rajonal, përkrahje financiare për biznese për të rinj, gra dhe grupe të marginalizuara, etj. Politikat tatimore kanë të bëjmë më shumë me formalizimin ekonomik, dhe rritjen e efikasitetit të mbledhjes së të hyrave përmes bashkimit të ATK-së dhe Doganës, krijimit të strukturave për mbledhjen e TVSH-së, por jo edhe rritjen e tatimeve, etj. Programi potencon rëndësinë e tregut të lirë, beson në një borxh publik në kontroll dhe kufizim të ngarkesës së ekonomisë vendore me borxh publik (f.19).

Sa i përket **Infrastrukturës**, programi qeverisës ka përfshirë edhe projekte infrastrukturore të mëdha. Këto projekte nuk kanë qenë në programin zgjedhor, por derivuan si kompromis i koalicionit me AAK-në, e cila kishte premtuar ndërtimin e Autostradës së Dukagjinit, Anamoravës, dhe pjesën e mbetur të Autostradës Prishtinë-Pejë. Në program qeverisës përveç këtyre përfshihet edhe përfundimi i punimeve në autostradën e Mitrovicës, dhe vazhdimin e autostradës në drejtim të Podujevës. Edhe pse në program janë cekur një sërë projektesh kapitale, sipas një hulumtimi të KDI-së rishikimi i buxhetit ka zvogëluar për 18% projektet kapitale të Ministrisë së Infrastrukturës. Sidoqoftë, përkundër zvogëlimit të buxhetit projektet kapitale janë shtuar.⁹ Prandaj nuk është e qartë sesi do të mund të implementohen këto projekte infrastrukturore.

e) Shteti social, mjedisi dhe kultura

Në programin zgjedhor të LDK-së ishin planifikuar më shumë politika sociale duke përfshirë edhe programin familjar për nënat dhe foshnjat që nuk gjeti vend në programin qeverisës. Në programin qeverisës nuk parashihet zgjerimi i shtetit social, por synohet përmirësimi në disa aspekte si, paga minimale, pensionet e banimit social, duke qenë kështu kryesisht i profilit të qendrës së djathtë. Në politikat e energjisë platforma zgjedhore dhe programi qeverisës ndjekin të njëjtat premtime. Në kulturë përmenden shumë investime kapitale si teatro e muze, por ato nuk janë të gjitha të përfshira edhe në programin qeverisës. Gjithashtu, sipas programit zgjedhor të LDK-së, në sport është premtuar ndërtimi i

⁸“The pandemic will leave the rich world deep in debt, and force some hard choices” The Economist, 23 Prill 2020

⁹ Shih “Ndikimi i rishikimit të buxhetit të shtetit 2020 në projektet kapitale të Ministrisë së Infrastrukturës”, KDI, infografikë, 7 korrik 2020, e qasshme në <https://bit.ly/30d8NUx>

shtatë stadioneve regjionale, të cilat nuk gjejnë më vend në programin qeverisës përveç ndërtimit të stadiumit nacional, ndërkaq parashihet renovimi i stadioneve të tjera ekzistuese.

Në politikat sociale, programi parasheh rishikimin e pagës minimale, rimodelimin të sistemit pensional dhe mbështetje për programin e banimit social. Mirëpo nuk parashihet shkurtimi i sistemit pensional duke përfshirë këtu edhe moskundërshtimin e pensioneve për 38 mijë veteran të cilat LDK kishte kundërshtuar fuqishëm gjatë kohës që ishin në opozitë. Në programin qeverisës janë të përfshira edhe gjithëpërfshirja, pushimi prindëror dhe banimi i parë që kanë qenë premtime në program zgjedhor. Në përgjithësi nga grupet sociale të komuniteteve jo shumicë dhe studentëve përmenden në disa politika ndihmuese si skema për mbështetje për punësim apo arsim. Gratë në anën tjetër përmenden, por vetëm me premtime për angazhim të mëtutjeshëm për të drejtat e tyre. Gratë përmenden me emërtimin biologjik “femër” në program. Sindikatat janë të përmendura vetëm dy herë dhe propozohet organizimi i tyre në përputhje me ekonominë e tregut. Ka gjithashtu mbështetje për programin e banimit social, masa lehtësuese për familje të reja, mbështetje për bujqësinë dhe fermerët.

Në politikat që prekin **energjinë dhe mjedisin**, programi synon rehabilitimin e TC Kosova B, dhe dekomisionimin e TC Kosova A, rishikim i TC Kosova e Re për realizimin e afatit optimal dhe studim fizibiliteti për kyçjen në rrjetin ndërkombëtar të gazit natyror TAP. Gjithashtu parashihen edhe investime në akumulime ujore dhe të ndërtimit të impianteve të ujërave të zeza, legjislacion për vlera kufitare të lirit të gazrave, kritere për mbrojtjen e ujërave, ajrit dhe të tokës, menaxhimin e parqeve nacional, mbështetjen e kompanive të menaxhimit të mbeturinave, etj.

Në aspektin kulturor gjithashtu ceket nevoja për më shumë mbështetje në aktivitete kulturore, mbrojtje ruajtje dhe promovim i trashëgimisë kulturore. **Në barazi** programi parasheh kryesisht idenë e djathtë të barazisë së mundësive (equality of opportunity) për të gjithë përfshirë grupet më në nevojë të shoqërisë (f.16). Sa i përket **shkollimit**, programi është i fokusuar në zgjerimin e edukimit parafillor.

5. Programi legjislativ i qeverisë

Për të bërë të mundur realizimin e synimeve dhe objektivave të Programit qeverisës, Qeveria krahas planit vjetor të punës përgatitë dhe miraton programin vjetor legjislativ, i cili përfshinë të gjithë aktivitetin legjislativ që do ta ndërmarrë qeveria brenda një viti kalendarik. Sipas praktikës, Qeveria brenda vitit mund ta plotësoj programin legjislativ edhe me projektligje të tjera kurdo që shih të nevojshme. Mbi bazën e programit legjislativ të Qeverisë, hartohet agjenda legjislative e Kuvendit me që Qeveria e Kosovës vazhdon të jetë sponsorizuesi kryesor i ligjeve në Kosovë.

Programi legjislativ i Qeverisë së Kosovës për 2020 është miratuar me 15 qershor 2020 dhe përmban gjithsej 129 projektligje.¹⁰ Prej tyre, shtatë projektligje janë të sponsorizuara nga Zyra e Kryeministrit dhe 122 projektligje janë të sponsorizuara nga 14 ministri prej 16 sa janë gjithsej. Nga këto 129 projektligje sa përmban ky program, 90 janë të reja dhe 39 të tjera janë plotësim - ndryshim i ligjeve ekzistuese. Nga

¹⁰ Programi Legjislativ 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës, e qasur më 25 qershor 2020, e qasshme në: <https://bit.ly/3dNZijb>.

tërësia e këtyre projektligjeve, 16 prej tyre janë projektligje për ratifikim të marrëveshjeve ndërkombëtare. Rreth 33% e projektligjeve që i përfshin programi legjislativ i qeverisë për këtë vit, derivojnë nga Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes për Stabilizim – Asociim (PKZMSA), ndërkaq pesë prej tyre janë edhe pjesë e Agjendës për Reforma Evropiane (ERA).

Ajo çfarë vlen të theksohet sa i përket përmbajtjes së këtij programi është fakti që 63 projektligje apo shprehur në përqindje 49% e programit legjislativ të këtij viti është i bartur nga ai i vitit të kaluar i kohës së qeverisë Haradinaj¹¹ meqë Qeveria Kurti nuk kishte miratuar një të tillë për shkak të periudhës së shkurtër kohore në qeverisje. Kjo fakt vë në pah dy elemente, e para tregon që qeveria aktuale, sikurse edhe ato paraprake vazhdojnë të propozojnë program legjislativ tejet ambicioz, që në praktikë nuk mund të realizohen më shumë se 50% dhe për pasojë barten nga viti në vit. Dhe e dyta që programi legjislativ i miratuar nga qeveria Hoti në masë të madhe e ka determinuar programin qeverisës dhe jo anasjelltas.

Përveç përmbajtjes është e rëndësishme të përmenden edhe sfidat që mund të pengojnë realizimin e plotë të programit. Një prej sfidave që mund të ketë ndikim në përmbushjen e tij është aspekti kohor. Një program legjislativ me 129 projektligje është mjaft ambicioz marrë parasysh periudhën e shkurtër kohore për realizimin e tij, vetëm gjashtë mujori i dytë i këtij viti. Nëse shohim trendin nga dy qeverisjet e kaluara (atë të vitit 2014 -2017 dhe 2017-2019), gjysma e projektligjeve nuk kanë arritur të procedohen në Kuvend nga ana e Qeverisë brenda një viti kalendarik ashtu siç janë planifikuar. Ndërkaq edhe Kuvendi po ashtu është po thuajse në të njëjtën dinamikë të punës, në dy legjislaturat e fundit, brenda një viti kalendarik nuk ka arritur ta përmbushë agjendën legjislative as deri në 50%. Një sfidë tjetër është edhe situata me pandeminë, që varësisht nga situata epidemiologjike në vend, fokusi kryesor i qeverisë do jetë menaxhimi i kësaj situatë dhe pasojave të saj. Përveç pandemisë, edhe situata e përgjithshme politike do të mund të ndikoj negativisht në përmbushjen e këtij plani.

Bazuar në programin qeverisës, **menaxhimi i pandemisë Covid -19** është një prej tri synimeve bazë por kjo nuk është reflektuar edhe në program legjislativ. Sipas Programit qeverisës parashihet “përcaktimi i hollësishëm i kornizës ligjore” mirëpo në programin legjislativ të këtij viti nuk është paraparë asnjë projektligj që rregullon këtë çështje. Mirëpo nëse shikohet në aspekt të aktivitetit legjislativ në fushën e shëndetësisë në nivel të përgjithshëm, Qeveria në programin legjislativ për këtë fushë i ka paraparë tri projektligje për këtë vit, të cilat janë të bartura nga programi legjislativ i vitit të kaluar dhe nuk ndërlidhen më çështjen e pandemisë.

Sa i takon **marrëdhënieve me jashtë**, në programin legjislativ, Qeveria ka paraparë draftimin e gjithsej pesë ligjeve që rregullojnë këtë fushë duke përfshirë këtu edhe atë për shërbimin e jashtëm ashtu siç e parasheh edhe programi qeverisës. **Në fushën e mbrojtjes** është paraparë vetëm një projektligj, që rregullon aktivitetet e deminimit humanitar të FSK-së.

Në fushën e sundimit të ligjit, program legjislativ parasheh hartimin dhe plotësim/ndryshimin e 20 projektligjeve. Katër prej tyre i takojnë **fushës kundër korrupsion**, që në fakt janë edhe obligime që

¹¹Shih Programin Legjislativ 2019, Qeveria e Republikës së Kosovës, e qasshme në: <https://bit.ly/31EOMKn>.

rrjedhin nga PKZMSA dhe ARE.¹² Ndërkaq sa i takon aktivitetit legjislativ që prek **fushën e administratës**, sipas këtij programi janë dy projektligje të parapara për draftim gjatë këtij viti. Projektligji për Qeverinë dhe ai për racionalizimin e agjencive të pavarura janë në linjë me programin qeverisës, ku është paraparë rishikimi i madhësisë së kabinetit qeveritar dhe i agjencive të pavarura.

Në rrafshin e politikave ekonomike, program legjislativ parasheh një numër të madh të projektligjeve për draftim gjatë këtij viti. Janë gjithsej 45 projektligje që përfshijnë fushën e financave (27), ekonomisë (3), tregtisë dhe industrisë (14) si dhe ndërmarrësisë (1). Nga këto 43 projektligje, 12 prej tyre i takojnë planit për rimbëkëmbjen ekonomike, prej të cilave është paraparë krijimi i fondit prej 1.2 miliardë euro për vitin 2020 - 2021. Kjo pako e projektligjeve për rimbëkëmbjen ekonomike përmban 10 marrëveshje ndërkombëtare financiare, ligjin për rishikimin e buxhetit dhe atë për rimbëkëmbjen ekonomike. Me këtë të fundit synohet plotësim – ndryshimi i tetë ligjeve ekzistuese që mundësojnë zbatimin e masave për rimbëkëmbje ekonomike.

Për **infrastrukturën**, në programin legjislativ janë paraparë tri projektligje për draftim gjatë këtij viti. Kurse sa i përket projekteve kapitale të parapara me programin qeverisës, këto mund të përfshihen në projektligjin për buxhetin e vitit të ardhshëm i cili i takon programit legjislativ të këtij viti që duhet të miratohet në fund të vitit.

Sa i përket fushës së **politikave të mjedisit**, Qeveria në programi legjislativ ka paraparë një numër të konsiderueshëm të projektligjeve që e rregullojnë këtë fushë, gjithsej 13 projektligje që përkrijnë edhe me planin për mjedisin që është paraparë me programin qeverisës.

Në fushën e kulturës (përfshirë këtu edhe sportin dhe rininë) janë paraparë gjithsej gjashtë projektligje për draftim gjatë këtij viti, që është edhe në linjë me prioritetet që parasheh programin qeverisës në këtë fushë. Gjashtë projektligje parashihen edhe **në sektorin e arsimit**. Për disa prej masave të parapara në programin qeverisës, siç është reforma në arsimin e lartë dhe zgjerimi i edukimit të hershëm, janë të përfshira edhe tek aktiviteti legjislativ në kuadër të programit legjislativ për këtë vit.

Tek **politikat sociale**, programi legjislativ për këtë vit përmban gjithsej shtatë projektligje. Ndër këto projektligje, parashihet edhe plotësim – ndryshimi i ligjit për skemat pensionale, ashtu siç parashihet edhe me program qeverisës.

¹² PKZMSA – Plani Kombëtar i Zbatimit të Marrëveshjes për Stabilizim – Asociim.
ARE – Agjenda për Reforma Evropiane.

Vlen të theksohet fakti që në programin qeverisës parashihet përmirësimi i procesit zgjedhor përmes ndryshimit të legjislationit të zgjedhjeve por që në program legjislativ të këtij viti nuk reflektohet ky premtim. Është paraparë vetëm plotësim – ndryshimi i Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike, që njëherit është edhe obligim që derivon nga ERA.

Tabela 4. Programi legjislativ 2020 sipas sponsorizuesve

Sponsorizuesit	Nr. i përgjithshëm i projektligjeve të sponsorizuara	Projektligje në plotësim/ndryshim	Projektligje të reja	Projektligje të bartura nga viti i kaluar	Marrëveshje ndërkombëtare
Zyra e Kryeministrit	7	4	3	4	1
Ministria e Financave	26	3	23	7	11
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	7	4	3	3	/
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	6	6	/	4	/
Ministria e Mbrojtjes	1	1	/	/	/
Ministria e Infrastrukturës	3	3	/	2	/
Ministria e Punëve të Brendshme	7	2	5	6	/
Ministria e Shëndetësisë	3	2	1	2	/
Ministria e Drejtësisë	19	4	15	12	/
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit	17	7	10	9	/
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	5	/	5	2	1
Ministria e Arsimit dhe Shkencës	6	1	5	3	2
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	7	2	5	3	/
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	14	/	14	7	1
Ministria e Zhvillimit Rajonal	1	/	1	/	/